



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 142 Prot

Tiranë, më 18.10. 2010

VENDIM Nr. 19 dt. 12.10.2010

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 12.10.2010, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. **Miratohet:** Projekt mbi ndërhyrjet restauruese në mozaikun e fasadës së Muzeut historik Kombëtar, Tiranë.
2. **Nuk u miratua:** Projekt "Ndërhyrjet konservuese në mozaikun "Qilimi i Apolonisë", Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë.
U vendos të zhvendoset mozaiku për në sektorin D në Apoloni, brenda 3 mujorit të parë të vitit që vjen.
3. **Miratohet:** Projekti i restaurimit të Kishës së Shën e Premtes, Çetë, Kavajë. Të bëhet një konsulencë paraprake me IMK, për të përcaktuar tipin e tjegullës që do të vendoset. Supervizimi i punimeve të objektit do të bëhet nga IMK.
4. **Miratohet:** Projekt restaurimi i fasadave në Bulevardin Republika Korçë, në kuadër të rikonstruksionit të këtij bulevardi. (Financuar nga Bashkia Korçë). me kushtet si më poshtë:
 - Të bëhet sondazh për përcaktimin e ngjyrave të lyerjes së fasadave.
 - **Nuk miratohet** ndërhyrja në banesën Stefi Gjermani. Fondi për restaurimin e kësaj banese ti kalojë një godine tjetër.
 - **Sugjerohet:** Zëvendësimi i vetratave duralumin me vetrata druri, në banesën me pronar Romi Veriga.

5. **Miratohet:** Projekt restaurimi e mirëmbajtje në Qendrën historike, Berat. (Paketë mirëmbajtje). **Punimet të mbikëqyrën nga IMK.**
6. **Miratohet:** Projekti i rikonstruksionit të një fragmenti në Pazarin e Krujës në pronësi të Z. Lulzim Roshi, Krujë.
7. **Miratohet:** Riformulimi arkitektoniko-urbanistik i banesës së Antoneta Pepës, Shkodër.
8. **Miratohet** varianti me shumë drifare, për "Projekt restaurimi, rikonstruksioni dhe përshtatje i dyqaneve Mangalem, në pronësi të Z. Thoma Kajanës, Berat".
9. **Miratohet:** Projekt restaurimi kisha e Shën Spiridhonit, Vuno, Vlorë.
10. **Miratohet:** Projekt restaurimi ish banesa e Luli Bajramit, sot në pronësi të Christopher Hadzopoulos K – 064, lagja Kala, Berat.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

FERDINAND XHAFERRAJ

SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE

